



Public Dialogue
on the Sustainable Use of
Energy in South-East Europe

AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE

Dokument rekomandues për legjislacionin e efiçencës së energjisë

(Propozime të ekspertëve dhe grupeve të interesit në
tryezën e rrumbullakët të organizuar në
Tiranë më 16 mars 2012)

Ky botim është përgatitur në kuadër të programit "Dialogu Publik për Përdorimin e Qëndrueshëm të Energjisë në Europën Juglindore", i zbatuar në Shqipëri nga Akademia e Studimeve Politike (e cila operon nën kujdesin e Këshillit të Evropës) me mbështetjen e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), nën kujdesin e Ministrisë Federale Gjermane të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit (BMZ)



Akademia e Studimeve Politike

Misioni i Akademisë së Studimeve Politike (ASP) është të forcojë një kulturë moderne politike bazuar në vlerat e përbashkëta të pluralizmit, tolerancës dhe dialogut të hapur, duke inkurajuar kështu zhvillimin e një komuniteti të politikanëve të rinj dhe qytetarëve, të dedikuar për zbatimin e modelit demokratik bashkëkohor të qeverisjes.

Programi i ASP implementohet me mbështetjen financiare të Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri (SCO-A). Programi gëzon një reputacion të dukshëm dhe mjaft pozitiv në rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare në vend dhe në rajon. Akademia bashkëpunon në organizimin e një

sërë aktiviteteve dhe projektesh me Delegacionin Evropian në Tiranë, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Fondin Evropian për Ballkanin, Fondacionin e Shoqërisë së Hapur, e shumë organizma të tjerë, si dhe merr pjesë rregullisht në aktivitete rajonale të Këshillit të Evropës dhe rrjetit të Shkollave të Studimeve Politike në rajonin e Ballkanit.



I themeluar në vitin 2007, programi i Akademisë së Studimeve Politike është ndjekur nga më shumë se 150 pjesëmarrës, të cilët tashmë janë pjesë e Rrjetit të Alumni dhe kontribuojnë në

realizimin e misionit kryesor të Akademisë.



HYRJE

Ky botim vjen si një dokument ndihmës për ministrinë e linjës dhe komisionet parlamentare, të cilat hartojnë dhe aprovojnë legjislacionin e energjisë në vendin tonë. Në përputhje me Direktivat Europiane dhe paketën e udhëzimeve për energjinë dhe mbrojtën e mjedisit, Shqipëria ka përcaktuar disa objektiva ambiciozë ndaj partnerëve dhe institucioneve ndërkombëtare në

lidhje me energjinë. Njëri prej tyre është edhe rritja e efikasitetit të energjisë me 9% deri në vitin 2018. Për të arritur objektivin e rritjes së efikasitetit të energjisë, duhet të punojnë së bashku të gjithë

sektorët e shoqërisë, jo vetëm institucionet publike dhe legjislative, por edhe shoqëria civile, ndërmarrjet, mediat dhe secili individ.

Nën këtë vullnet dhe në kuadër të projektit "Dialogu Publik për Përdorimin e Qëndrueshëm të Energjisë në Europën Juglindore",

Akademia e Studimeve Politike organizoi një tryezë të rrumbullakët me politikëbërës, ekspertë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile e të biznesit. Debati i hapur i pjesëmarrësve synoi krijimin e një platforme diskutimesh rreth projektligjit të ri të Efikasitetit të Energjisë, i cili pritet të paraqitet për aprovim në Kuvendin e Shqipërisë. Qëllimi kryesor i debatit ishte jo

vetëm

përmirësimi i projektligjit dhe përfshirja e sugjerimeve të të gjitha grupeve të interesit, por njëkohësisht edhe diskutimi i veprimeve dhe masave që duhen marrë për të siguruar

zbatueshmërinë e ligjit dhe arritjen e objektivave të vendosura.

Sugjerimet më të mira të ekspertëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, u regjistruan dhe po përblidhen sot në këtë dokument rekomandues.



(Pjesë nga fjala e mirëseardhjes nga Z.Erjon Tase, Akademia e Studimeve Politike dhe Z.Ismail Beka, GIZ Albania)



REKOMANDIMET KRYESORE

Ekspertët dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit bien dakord se hartimi i legjislacionit për efikasitetin e energjisë është mjaft i rëndësishëm dhe duhet përfunduar sa më shpejt. Në mënyrë që ky legjislacion të gjejë zbatim dhe të jetë efikas nevojitet:

- Krijimi i Fondit Kombëtar të Efikasitetit të Energjisë, si kushti themelor për incentivat në këtë sektor dhe zbatimin në praktikë të ligjit në sektorin publik dhe sidomos atë privat. Nuk do të ishte e udhës aprovimi i projektligjit të ri pa krijimin e këtij fondi. Një hap i mëtejshëm pozitiv është krijimi i Fondit të Efikasitetit jashtë linjës së buxhetit, duke evituar problemet nga pamundësia financiare apo përdorimin e tij për emergjencë të tjera.
- Përcaktimi i qartë i strukturës kombëtare, e cila do të kryejë monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të ligjit, jo vetëm në nivel qendror, por edhe në atë vendor. Pa një strukturë të tillë, nuk mund të kryhen matjet, vlerësimet dhe të zbatohen masat e para-
- shikuara në kursimin e energjisë.
- Trajnimi dhe përgatitja në sektorin e efikasitetit të energjisë i personelit të administratës publike dhe vendore, veçanërisht në zyrat ku kryhet pranimi dhe ndjekja e projekteve të ndërtimeve në bashki dhe komuna.
- Rakordimi në strategjitë e zhvillimit të institucioneve qendrore dhe njëkohësisht të pushtetit vendor, për të stimuluar hartimin e masave efikase. Nevojitet që aktorët kryesorë të qeverisjes vendore dhe lokale të përcaktojnë objektivat e zhvillimit në respekt të detyrimeve të ndërrmara në rritjen e efikasitetit të energjisë.



DISKUTIMET E PJESEMARRESVE

Z. Agim Bregasi, drejtor i
departamentit të Energjisë
në METE

“Nevoja e këtij projektligji lindi jo vetëm si pasojë e rëndësisë së përcaktuar nga qeveria shqiptare për rritjen e efikasitetit të energjisë, por edhe në kuadër të nismës së BE-së të quajtur 20-20-20. Ne synojmë që të përcaktojmë sa më saktë që të jetë e mundur të gjitha procedurat e nevojshme në mënyrë që të zbatohet Planin Kombëtar të Veprimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave më 7 shtator 2011 për rritjen e efikasitetit të energjisë. Është menduar që të jetë një ligj më vete duke e ndarë nga ligji për energjitë në përgjithësi si edhe nga ligji për energjitë e rinovueshme, duke e vlerësuar edhe këtë si një sektor mjaft të rëndësishëm. Projektligji është hartuar në bashkëpunim me universitetin e Sienës, me financim të qeverisë italiane, është marrë mendimi nga institucionet përkatëse. Natyrisht që diskutimi në këtë panel do të jetë i vlefshëm sepse është e nevojshme që të merren parasysh edhe mendimet e kualifikuara nga ekspertët, shoqëria civile dhe pushteti vendor. Ne do të jemi të hapur për të marrë parasysh sugjerimet që do të sillen në këtë tryezë dhe do t'i paraqesim në

materialin që do t'i dërgohet Këshillit të Ministrave dhe komisioneve parlamentare.

Përsa i përket risive që sjell ky projektligj, duhet vënë theksi mbi:

-përcaktimin e masave për efikasitetin e energjisë në izolimin termik të banesave dhe çertifikimin e tyre sipas nivelit të efikasitetit,

-çertifikimin e pajisjeve elektroshtëpiake në tregun shqiptar

-përcaktimin e strukturave përkatëse audituese, të cilat do të bëjnë të mundur kontrollin dhe zbatimin e këtyre masave. Si strukturë bazë për monitorimin e efikasitetit të energjisë konsiderohet në ligj një agjensia kombëtare, e cila në kuptimin tonë mendohet të jetë Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore – AKBN, e cila ka eksperiencën dhe strukturat e duhura për të marrë hapat e duhura në krijimin dhe përcaktimin e politikave për efikasitetin qoftë në nivelin qendror, qoftë në atë lokal.

- Krijimi i fondit të Efikasitetit të Energjisë.

Në parim thuhet që do të krijohet fondi i efikasitetit, ndoshta ky fond mund të jetë i përbashkët edhe me atë për energjinë e rinovueshme,



edhe për të mos krijuar struktura të tepërta në sistemin buxhetor të qeverisë. Mund të jetë një fond pra, por duke pasur menaxhim të kujdesshëm. Fondi parashikohet të mbushet me një kontribut të buxhetit të shtetit, sepse edhe në planin e veprimit të miratuar në shtator të vitit të kaluar, çdo ministri ka detyrim të bëjë investime në rritjen e energjisë. Por përveç kësaj, mund të ketë edhe financime ekstra nga buxheti. Ky fond mund të ketë grante nga burime të tjera financiare,

shoqata të ndryshme vendase apo të huaja dhe mbështetje globale. Mund të ketë donacione nga burime financiare private. Nëse do të jetë e mundur, jemi të hapur për instrumente të tjerë financiarë, si bankat.

-parashikimi i krijimit të një agjencie kombëtare të energjisë. Kjo strukturë do të ketë kompetenca për eficientë e energjisë. Mënyra e financimit më pas do të diskutohet dhe përcaktohet në aktet e mëtejshme nënligjore. Ne mendojmë, që drafti në tërësinë e tij është i mirë, megjithatë, jemi të hapur për diskutime e vërejtje. "


Z. Jemin Gjana, kryetar i Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

"Zhvillimi i tryezave të tilla është i rëndësishëm. Unë çmoj se në strukturat e shoqërisë civile, që punojnë me programe të shoqërive evropiane, por dhe jo evropiane, janë atashuar një pjesë e mirë e elementëve të mirëshkolluar që kanë një nivel të lartë ekspertize. Ky nivel ekspertësh nuk duhet të mbetet



jashtë diskutimeve të tilla. Këto struktura të shoqërisë civile, bëhen dhe mbeten eficientë kur në vend që të bëjnë politikë, bëjnë politika. Ka mjaft struktura që bëjnë politikë dhe pak nga ato që bëjnë politika. Prandaj është mirë që shoqëria civile të bëjë politika.

Në qoftë se ka ndonjë vend, në Evropë që ka nevojë për ligj dhe protokolle të detajuara për eficientë e energjisë, jemi ne. Nuk mund të krahasohemi as me Malin e Zi, Maqedoninë as me Kosovën, ku sistemi i banesave, rrjeti i shpërndarjes së gazit, etj janë absolutisht shumë herë më mirë se



sa tek ne. Ne për këtë çështje kemi një trashëgimi më të keqen e mundshme. Kjo është lufta e parë që duhet të bëjmë me vetveten. Jemi para dy detyrimesh sot. E para problemet e efikasitetit do të lidhen me burimet dhe kostot e saj, ku burimet kanë ardhur duke u pakësuar për efekt të përdorimit të madh dhe çmimet janë duke u rritur në mënyrë galopante. E dyta janë detyrimet që kemi nga Brukseli. Kemi detyrime që vijnë nga Sekretariati në Vjenë dhe ne jemi të detyruar që t'i zbatojmë.

Unë nuk e kam parë ligjin, por në qoftë se do të vini me gjëra të strukturuar dhe të keni argumenta të mirëfillta, që ta bëjnë ligjin më të mirë e të zbatueshëm, do të keni të gjithë hapësirën për t'u dëgjuar nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, që është komisioni përgjegjës.

Detyrimet që do të vendosen ndaj projektuesve dhe ndërtuesve duhen parë mirë, sepse nuk besoj se e vrasin shumë mendjen për këtë pjesë. E dyta, forca e kontrollit, monitorimit duhet të fokusohet fillimisht tek konsumatorët e mëdhenj të energjisë. Më parë se të


kontrollojmë 800 mijë konsumatorë familjarë, më mirë të kontrollohen konsumatorët e mëdhenj të energjisë. Gjithashtu ato që do i quajmë konsumatorë publikë të energjisë elektrike, dhe janë shumë, shkolla, spitale, ushtri, polici, që kanë një konsum shumë të madh. Të tretët duhet të monitohen bizneset, që janë ato prodhuese. Dhe të fundit, duhet ta kërkojmë efikasitetin tek qytetarët.

Është shumë e rëndësishme çështja e fondit të efikasitetit që diskutohet edhe në këtë tryezë. Secili sektor kërkon një fond, mjedisi kërkon një fond, bujqësia kërkon një fond, dhe duhet të kemi parasysh realitetin dhe duhet ta vëmë çdo kërkesë të ligjit në balancë me nivelin financiar të shtetit. "

Z. Pajtim Bello, ish-zëvendësministër i Energjitikës

"Ky projektligj merret me një nga çështjet më të rëndësishme, siç është energjia. Aktualisht ne kemi një sistem, ku energjia vidhet hapur në të gjitha format dhe realisht asnjë nuk është marrë seriozisht me këtë





situatë. Ky ligj trajton një çështje që lidhet me interesa të mëdha të shoqërisë. 20 përqind e efijencës në përdorimin e energjisë, përkthehet në 1.4 miliardë kilovat orë energji elektrike në vit dhe 180 mijë tonë nënprodukte të naftës. Po ti shikosh në balancë ekonomike kuptohet që këto janë shuma të mëdha financiare. Gjatë këtyre 20 viteve të fundit, ne kemi importuar energji elektrike dhe nënprodukte të naftës duke kontribuar në rritjen ekonomike të vendeve të rajonit, në vend që këto vlera të përdreshin në rritjen ekonomike të vendit tonë.

Pra, nëse vizioni strategjik i ekonomisë sonë do të drejtohej tek efica e energjisë, ne do të kursenim importin e atyre 1 miliardë kilovat orëve dhe njëkohësisht 100 apo 200 milionë euro që do të shkonin në ekonomitë e vendeve fqinje, duhet të shkonin në fushën e efijencës së energjisë. Duke e menduar në një mënyrë të tillë, mund të argumentohet edhe mënyra se si mund të financohet ngritja e fondit të efijencës së energjisë dhe vlera e tij. Eshtë mjaft i rëndësishëm krijimi i këtij fondi si kushti themelor për incentivat në efica e energjisë dhe zbatimin e ligjit. Gjithashtu, duhet të nënvizoj se vonesat e mëtejshme, rrezikojnë gjithashtu edhe investimet e huaja në sektorin e energjisë dhe teknologjive të energjisë së

rinovueshme. Ato investime që janë vënë në punë deri më sot, janë të pakta, por janë premtuese dhe mjaft të rëndësishme për të ardhmen.

Projektligji sigurisht që do të plotësohet nga shumë akte nënligjore pas aprovimit të tij, megjithatë unë kam disa sugjerime në gjuhën teknike të përdorur, të cilat mendoj se do të jenë të vlefshme. (Sugjerimet e detajuara të Z.Bello iu transmetuan grupit të punës për projektligjin)

Z. Ismail Beka, GIZ Albania

“Një aspekt mjaft i rëndësishëm për realizimin e detyrave dhe angazhimeve në fushën e efijencës së energjisë, është komponenti i burimeve njerëzore. Në Shqipëri ka pak specialist të kësaj fushe, por më e rëndësishme është fakti që në strukturat përkatëse të institucioneve qendrore (Ministri) dhe institucione të tjera të specializuara (si AKBN) dhe në nivel lokal (bashki apo komuna), numri i personave të punësuar, të cilët kanë në detyrat e tyre funksionale efica e energjisë, (qoftë edhe 50 përqind të kohës së punës) janë shumë të pakta. Kështu, METE ka një drejtor të Politikave Energjitike; AKBN një sektor për efica e energjisë (me një numër të kufizuar personash). Pra në total, në nivel qendror më pak se 10 persona, të cilët duhet të merren me të gjitha detyrat,



strategjitë, planin e veprimeve, rishikimin e legjislativioneve, monitorimin, apo funksione të tjera në këtë fushë. Edhe në nivel të pushtetit vendor, GIZ -ja është duke bashkëpunuar së fundi me bashkinë e Tiranës, (kryeqytetit ku edhe shpenzohet më shumë se 1/4 e energjisë në shkallë vendi), në fushën e efikasitetit të energjisë nuk asnjë strukturë apo edhe një punonjës të vetëm që të thuhet se është personi që duhet të ketë njohuri dhe të menaxhojë efikasitetin e energjisë.

Si rrjedhojë, gjykoj se ky projektligji që po na paraqitet dhe aktet e mëtejshme nënligjore duhet të fokuson më tej në përcaktimin e strukturave përkatëse për Efikasitetin e Energjisë në institucionet qendrore dhe gjithashtu edhe në pushtetin vendor (bashkitë, komunat), sepse krahas efikasitetit të energjisë në objektet publike, aty (në pushtetin vendor) jepen lejet e ndërtimit, licencat për sektorin privat. Aty duhet të certifikohen, aty duhet të bëhen statistikat dhe matjet e objektivave të kursimeve të energjisë”.



Z. Edmond Hido, Drejtor i Qendrës për Efikasitetin e Energjisë Shqipëri – BE

“Shqipëria ka patur një ligj për efikasitetin e energjisë mjaft të mirë (aprovuar në vitin 2005), por që nuk u zbatua për shkak se nuk u bë efektiv/aktivizua fondi i efikasitetit të energjisë e shumë faktorë të tjerë. Dua të them se edhe ky ligj, nëse nuk do të aprovohet fondi i efikasitetit të energjisë, ne do të kemi sërish një ligj që nuk do të zbatohet në

praktikë. Pra nëse nuk do të ketë fond efektiv, nuk do të ketë zyra rajonale të efikasitetit të energjisë, nëse nuk do të trajnohen personeli KRT-ve të bashkive (të paktën 1-2 persona për çdo

bashki), si mund të raportojmë ne në Vjenë se kemi kursyer kaq apo aq energji. Ky ligj është mjaft i mirë teorikisht, ka shumë përafërsi me realitetin e Italisë apo vendeve të tjera evropiane, por realisht them se në Shqipëri nuk do të ketë zbatim sepse ne akoma nuk detyrojmë dot qytetarët, firmat e ndërtimit apo edhe institucionet publike që të zbatojnë kodin energjistik të banesave që është hartuar që në vitin 1998.



Insistoj se projektligji duhet të miratohet kur të jetë aprovuar dhe bërë efektiv fondi i efikasitetit të energjisë. Për mendimin tim, duhet të jetë një fond i vecantë dhe jo ashtu siç po diskutohet i bashkuar me fondin e energjive të rinovueshme sepse atëherë do të degradohet dhe do të ndahet më shumë për atë krah që është më me interes për politikën në një moment të caktuar. Fondi i efikasitetit duhet të shërbejë për projekte pilote, për mbulimin e kostove shtesë si edhe për nxitjen e investimeve në këtë fushë dhe fushata sensibiluese.

Ky ligj duhet të nxisë edhe bashkëpunimin me pushtetin lokal, bashkitë. Ne si Qendër për Efikasitetin e Energjisë kemi bashkëpunuar me rreth 12-14 bashki të ndryshme si edhe kemi hartuar plane 5-vjeçare se çfarë duhet të bëjë çdo bashki (që është pjesë e projekteve tona) për efikasitetin e energjisë në kopshte, çerdhe apo godina publike në pronësi të tyre. Në qoftë këto plane nuk do të vihet në jetë atëherë ne nuk do të arrijmë kursimin në shumatorën kombëtare që jemi zotuar të realizojmë dhe duhet të raportojmë si arritje në Sekretariatit e Vjenës."

Z. Gjergj Simaku, ish-kreu i
Agjensisë Kombëtare për
Energjinë

"Problemi i aprovimit të këtij ligji është tepër urgjent, por njëkohësisht

është e nevojshme që ky ligj të mos jetë në rangun e ligjeve të kaluara dhe problematikën e zbatimit të tyre. Agjensia Kombëtare e Energjisë bëri një punë mjaft të shkëlqyer në vitin 2002. U ndjeva shumë i lumtur kur doli në vitin 2003 një ligj për performancën energjitike dhe ky ishte një problem jo vetëm shqiptar por edhe evropian. U gëzova në vitin 2005 për ligjin e ri, por u hidhërova kur mësova se që në vitin 2006 ky ligj do të ndryshohej. Sot jemi në vitin 2012 dhe ky ligj është akoma në tavolinat tona. Fatkeqësisht gjykoj se jemi në një pozicion tepër të vështirë, qoftë me njëri-tjetrin, qoftë në raport me energjinë dhe flasim sot për fond të efikasitetit të energjisë kur duhet të flasim më shumë për kilovatë të kursyera. Ky duhet të jetë edhe morali i ligjit.

Të them të drejtën, meqenëse kam lexuar me vëmendje ligjin e parë, meqenëse jam bashkautor në ligjin për "ruajtjen e nxehtësisë në banesa", kemi hartuar një fletore zyrtare me shumë faqe, një teori të tërë, të them të drejtën e kam përdorur atë fletore vetëm për një ekspertizë gjyqësore për t'u mbrojtur nga ata që thoshin se duhet 100, 200 apo më shumë kilovatë për të ngruhur një ndërtesë. Ndërkohë që ndërtesave nuk u është dashur fare ky ligj që kemi bërë ne dhe kemi mbërritur tashmë në një pikë që duhet ta ribëjmë.



Mesa shihet në pamje të parë, duket se projektligji nuk është ligj shqiptar por i ndërtuar jashtë vendit. Nëqoftë se vijmë në kushte e Shqipërisë ne duhet të flasim në kushte reale. Pra do të bëjmë një audit real të situatës në vend. Kushdo ekspert e di që një audit do të thotë që të zbulosh se sa energji ka shpenzuar ndërtesa në jetën e saj. Dhe më pas të marrësh masa për eficientë e energjisë. Dhe më tutje, të gjesh një pikë se ku duhet të zbrësh shpenzimin. Pra çfarë masash duhet të marrësh për të rritur eficientë.

Ky ligj është një përzierje e ligjit të vjetër dhe masave që rekomandohen nga Bashkimi Evropian. Deri më sot, ne nuk kemi zbatuar

asnjë ligj që kemi miratuar për eficientë dhe duhet të jemi më seriozë me hartimin e ligjit të ri dhe bëjmë ligje të aplikueshme. Me një ligj që do të kapte disa objektiva të BE-së, ne duhet të themi troç që duhet të ecim në këtë rrugë dhe do arrijmë nga gjendja aktuale, në një nivel të përcaktuar. Unë mendoj se edhe ky projektligj nuk e bën një gjë të tillë.




Duke u fokusuar tek pjesa e ndërtesave, unë them që nuk duhet injoruar ligji ekzistues, por ai ligj duhet përkthyer në këto terma që thamë më lart. Le të gjykojmë që me një fond apo me një projekt, apo me aplikime të termave të referencës, ne të ndërtojmë qoftë edhe një laborator ku të nxjerrim performancën energjitike të ndërtesave tona. Askush deri më sot nuk mund të thotë se sa janë humbjet në një ndërtesë në kushtet

e Shqipërisë. Nevojitet matje analitike që të gjithë të themi se sa humbje ka banesa dhe të përcaktojmë edhe nivelet që nevojiten.

Ligji duhet të parashikojë qoftë edhe një akt nënligjor dhe të thuhet troç, ashtu siç kemi thënë dhe në ligjin e mëparshëm që ne kemi një performancë energjitike të tillë dhe këtë nivel do ta cojmë në një nivel më të ulët. Se kush do ta bëjë këtë, duhet ta përcaktojë ligji.

Ajo që është edhe më e rëndësishmja është fakti që deri në ligjin e kaluar, ligji për eficientë në banesa, duhet të jetë më i detajuar, për të mbërritur deri në çertifikatën e ndërtesave. Ky ligj duhet të ketë dy



këmbë, pra duhet të ketë sjelljen termike të ndërtesës dhe impiantin. Të dyja paraqesin në vetvete një licencë energjie. Le të projektojmë ndërtesa me këtë licencë energjie, në mënyrë analitike, dhe pastaj të veprojmë duke i çertifikuar ato pra njëkohësisht të vendosim edhe sisteme licence të energjisë, që në Shqipëri sigurisht është energjia elektrike. Kështu që unë nuk mendoj se këto që thuhet në projektligj e zgjidhin këtë problem shqiptar dhe gjykoj që donatorët duhet të kontribuojnë në ndërtimin e disa termave efience për të ndërtuar një ligj për eficientë e energjisë në banesa. "

Z. Besim Islami, ish-drejtor i
Qendrës së Eficientës së
Energjisë

"Për krijimin e fondit të eficientës, në vitin 2005 kemi bërë deri katër muaj debat në parlament. Politikanët na dëgjuan, por një vit më pas na harruan dhe erdhëm tek mendimi i ndryshimit të ligjit që në vitin 2006. Që të mos vijmë përsëri tek kjo pikë, është mjaft e rëndësishme që të veprojmë tani. Mesa jam në dijeni, projektligji i ri ka hasur në vështirësinë e sigurimit të një aprovimi nga Ministria e Financave për ngritjen e Fondit të Eficientës së Energjisë. Ne duhet të ndërtojmë një fond efience pasi në të kundërt nuk mund të bëjmë asgjë në ndryshimin

e situatës. Nga eksperiencia në Kosovë, mund t'iu them se kjo është pika më e vështirë dhe që diskutohet. Kroacia është ndërkohë shembulli më i mirë që duhet ndjekur, e ka ndërtuar këtë fond për eficientë e energjisë, ekonomitë e fushës dhe mjedisin. Nëse do ta ndajmë këtë fond në të treja këto zona, do të duhet që të preken tre ligje të ndryshme dhe kjo do kohë. Fondi i eficientës së energjisë duhet të krijohet që të jetë jashtë linjës së buxhetit, pasi në të kundërt është e pamundur që të kemi një përdorim efikas të tij, pasi do të ketë gjithmonë nevoja apo emergjencia të tjera që duhet financuar nga buxheti. E kemi provuar këtë me ligjet e mëparshme dhe kurrë nuk u krijua ky fond. Pra duhet një strukturë e vecantë.

E dyta, mbi çertifikimin e banesave. Janë 32 akte nënligjore dhe VKM për të zbatuar këtë ligj pasi është mbështetur mbi dy direktiva kryesore evropiane dhe ne detyrohemi si Shqipëri që t'i monitorojmë. Ne nuk na pret Evropa për vitin 2018 që të arrijmë targetin e 9 përqindshit. Na kërkohet targetin prej 3 përqind që në vitin 2012, që ne sigurisht që nuk e arrijmë dot. Deri më sot jemi mësuar që të përgatishim plane dhe zotime 10 vjeçare dhe kemi arritur në fund të këtij afati me përgjigjen që nuk e zbatuam dot. Evropa ka ndryshuar tashme strategji dhe ashtu si edhe vendeve të tjera edhe



ne do të na kërkohet që të planifikojmë objektivat për energjinë vit për vit. Duhet të rishikojmë të gjithë Planin Kombëtar të Efiçencës së Energjisë. Monitorimi është një pjesë mjaft e rëndësishme e projektligjit.

Ne duhet të kemi një agjensi për energjinë dhe jo një strukturë brenda AKBN, sepse ekspertët e AKBN nuk mund të monitojnë situatën dhe të raportojnë në Vjenë se sa energji u kursye çdo vit. Nëse ne nuk zbatojmë këto detyra, sigurisht që nuk do na hapen dyert për t'u bërë pjesë e Evropës. Për këtë arsye, nevojitet një agjensi kombëtare që të ketë zyra rajonale në çdo prefekturë të vendit.

Përsa i përket pjesës së projektligjit për krijimin dhe menaxhimin e sistemit të të dhënave, duhet të kuptohet se kjo nuk i përket vetëm konsumatorëve të mëdhenj, por edhe për çdo konsumatori tjetër. AKBN apo agjensia përgjegjëse për energjinë, duhet të bëjë të paktën çdo 3 vjet një studim se si është konsumuar energjia në familje, në ambientet publike, në industrinë e madhe apo të vogël. Në Kroaci ka ligj ku zyra e legalizimit të ndërmarrjeve mund t'i

dërgojë pronarit të një dyqani një formular ku i kërkon të raportojë se si e konsumon energjinë dhe mund të zbulojë se sa energji konsumohet dhe sa efiçencë ka në programet lokale.


Ne flasim për auditorë energjie, por duhet të kemi parasysh se Kosova, përshembull ka 3 vite që e ka implementuar këtë sistem auditimi. Ne në Shqipëri nuk kemi ende audituesit dhe çertifikuesit e energjisë.

Në përfundim është një ligj i domosdoshëm, por edhe i vonuar. Eshtë e nevojshme që të kemi shumë akte nënligjore për ta kthyer këtë ligj të zbatueshëm, por sikur çdo muaj ne të hartojmë nga dy akte nënligjore apo VKM që t'ia

paraqesim Këshillit të Ministrave për aprovim, do të kemi mundësinë që t'i plotësojmë të gjitha aktet e nevojshme. Dua t'u them kolegëve të mi, se edhe pas aprovimit të këtij ligji kemi shumë punë për të bërë, në mënyrë që ai të gjejë zbatim."

Z. Artan Leskoviku, Drejtor i sektorit të Efiçencës së Energjisë pranë AKBN
"Çështja e parë është problemi i menaxhimit dhe vënja në kontroll e





energjisë elektrike. Në rast se nuk kemi një menaxhim të tillë, është e pamundur që të flitet për efikasitet energjie.

Së dyti është çështja e ngritjes së një strukturë të caktuar që do të merret me zbatimin e këtij ligji. Projekligji i efikasitetit dhe ai i energjive të rinovueshme janë hartuar me ekspertizë të huaj mjaft profesionale, por kanë anashkaluar përcaktimin e saktë të strukturës që do të kryejë monitorimin dhe zbatimin e këtij ligji. Nëse nuk ka një ndarje të qartë të kësaj detyre, apo krijimi i institucionit dhe strukturave përkatëse, sigurisht që do të mbetet e pazbatuar në nivelin e duhur.

Pika e tretë, që e përmendën pak edhe deputetët që ishin të pranishëm, është fakti se efikasiteti dhe tematika e saj, kërkon krijimin e një task force qeveritare, e cila të ndikojë me forcën e saj në ndryshimin e situatës aktuale. Nëse nuk i jepet një prioritet i tillë, është e pamundur që ne, 4-5 ekspertë që jemi në AKBN, të mund të ndërgjegjësojmë të gjitha strukturat përgjegjëse që duhet të merren me këtë detyrë të rëndësishme. "

Z. Ramadan Alushaj, Fakulteti i
Inxhinierisë Mekanike

"Për herë të parë na ka ardhur një ligj i ndërtuar mirë, edhe pse nevojiten disa rregullime teknike.

Këtu po diskutohet shumë për ligjin e mëparshëm të energjisë dhe mund të them se ai përfshihet në këtë ligj dhe me akte nënligjore të cilat po shqyrtohen në tavolina të tjera. Shumë prej problemeve që u ngritën nga tryeza e sotme, do përfshihen në akte nënligjore që janë në procedurë e sipër. Unë mendoj se sot duhet të japim një mendim nëse ky ligj ka nevojë të rishikohet dhe të bëhet i përshtatshëm për të shkuar në Kuvend.

Për mendimin tim ky ligj përbën bruto e parë që ka bazën fillestare. Për më tej duhen ngritur një grup specialistësh me ekspertin juridik, energjistik dhe arkitekturën, të cilët duhet të ngarkohen me përgjegjësi për të analizuar këtë draft dhe të sillen mendime që të diskutohen.

Rrugë tjetër nuk ka. Një punë e mirë mund të bëhet vetëm duke përcaktuar me përgjegjësi personat e duhur për të dhënë vlerësimet e tyre.

Sigurisht që jam dakord me kolegët e tjerë, se pjesa më e rëndësishme e këtij ligji është krijimi i fondit të efikasitetit të energjisë. Pa një fond të tillë nuk mund të ketë sukses dhe unë mendoj se duhet të insistojmë edhe në sferat e tjera apo edhe parlament, për të krijuar një fond të tillë. "



Z. Artan Shkreli, kryetar i
shoqatës së Arkitektëve të
Shqipërisë

“Duhet të analizojmë se përse nuk zbatohet ligji ekzistues dhe pastaj mund të bëjmë edhe një ligj të ri që të jetë i zbatueshëm. Unë po flas përse i përket sektorit ku kam më shumë njohuri, ndërtimit. Një nga hallkat ku këputet ekzekutimi i ligjit është administrata vendore në bashki dhe komuna. Ne si arkitektë jemi të detyruar teorikisht që në procesin e projektimit të godinave dhe territorit duhet të marrim parasysh edhe kodet ekzistuese të efijencës së energjisë. Realisht kjo nuk ndodh dhe është lënë në ndërgjegjen e vetë ndërtuesve,

zhvilluesve. Po të shikoni në ndërtimet në Tiranë ka tri grupe godinash: janë godinat që pak a shumë e marrin parasysh kodet e efijencës; ato që nuk e marrin parasysh, sidomos ato në periferi; dhe një numër shumë i vogël që janë shumë përpara ligjit tonë dhe të krahasueshme me normat evropiane. Këto janë tregues i rëndësishëm se


ka një vullnet, një mundësi, por edhe një njohuri e arkitektëve dhe zbatuesve shqiptarë që janë në gjendje që t'i zbatojnë këto norma nëse lejohen.

Pika e dytë, ku doja të ndalesha është nevoja për trajnimin në këtë sektor të efijencës i administratës publike pikërisht në zyrat ku kryhet pranimi dhe ndjekja e projekteve të ndërtimeve në bashki me komuna.

Me përgjegjësinë e kryetarit të shoqatës së Arkitektëve, unë ju konfirmoj se nuk ekziston nga Shkodra deri në Sarandë asnjë nukël, qoftë edhe i vogël në këshillat teknike të këtyre njësive vendore, që të jetë i aftë për të kryer kontrollin teknik të projekteve përse i përket kushteve të efijencës së

energjisë. Për fat të keq, nuk ka asnjë trysni ndaj këtyre bashkive nga ministria e Transporteve apo institucionet e tjera të linjës, për të vënë në vend këtë problem. Dhe në këtë rast flitet për shkeljen e ligjit dhe jo për një zgjedhje. Në këtë ligj duhet një dispozitë që të jetë obligatore dhe më në fund të zbatohet në praktikë.”






Z. Arben Biçoku, shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë

“Ne e quajmë një iniciativë pozitive. Kemi qenë pjesë edhe e tavolinave të tjera për eficientë e energjisë dhe kemi pasur raste që të japim mendimet dhe këndvështrimet tona. Një pjesë të madhe të harxhimit të energjisë e përbëjnë ndërtesat. Mesa di unë diku tek niveli 40 përqind i energjisë. Pra, mënyra se si ne do ta përcaktojmë në këtë projektligj sjelljen në ndërtesa, nuk është e parëndësishme për objektivat në eficientë e energjisë. Ky ligj është një nga ato çelësat, që po të jemi të zgjuar, me anë të të cilave mund të fitojmë kohën e humbur.

Përsa i përket më konkretisht projektligjit, dua të ndalem në disa pika. Praktikisht në vendet më të zhvilluara, ekzistojnë incentiva financiare dhe struktura përkatëse për ndërhyrje në termoizolim apo përdorimin e praktikave të eficientës. Pa këto incentiva këto ndërhyrje nga pikëpamja e një investitori privat, nuk do të rezultojnë ineresante ekonomikisht sepse kanë një afat shlyerje të gjatë. Disa nga masat, pershembull termoizolimi është shumë efikas, por ka edhe shumë masa të tjera që janë eficientë. Por të gjitha këto masa kanë nevojë për stimul. Këtu qëndron edhe zgjuarsia e shtetit, që mëpërmjet kuadrit të duhur ligjor të gjejë mekanizma që stimulojnë këto ndërhyrje eficientë.

Mesa e kam parë unë projektligjin, të krijohet përshtypja se objekt i veprimit të tij janë vetëm ndërtesat e reja. Fondi i banesave private është shtuar me 50% deri në vitin 1990 dhe pas kësaj periudhe këtij fondi i është shtuar një 30% tjetër. Tashmë jemi në një fazë kur kemi një nivel ndërtimi për frymë të krahasueshme me vendet e rajonit dhe uria për ndërtime të reja do të bjerë. Ajo që do të shohim, do të jetë rikonstruksioni i fondit ekzistues të banesave.

Në këtë aspekt unë nuk e gjej shumë të zgjidhur në projektligj se si mund t'i afrohem nëpërmjet incentivave nxitjes së rindërtimit me masa eficientë. i vetmi nen në projektligj, që flet për incentiva i adresohet ndërmarrjeve shumë të mëdha industriale, që janë mbi një nivel të caktuar energjitik. Për mua pjesa që nuk bie dakord është pjesa që edhe në këtë pikë, adresohen në ato pozita që rrezikojnë që të lejojnë përzgjedhjen e ndërmarrjeve të caktuara duke patur parasysh nivelin e korrupsionit që ekziston në administratën publike. Sa do të jetë fondi i eficientës së energjisë ? Kjo pjesë si edhe pjesa e incentivave që mund të ndihmojnë qytetarët që të shtyhen drejt praktikave të rinovimit të banesave duke përdorur standartet e eficientës së energjisë në banesa, duhet të përcaktohet më mirë në legjislacion.”



Z. Anthim Vjero, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë

“Mendoj se duhet përcaktuar qartë në projektligj se sa do të jetë financimi që do të jepet nga buxheti i shtetit për eficientë e energjisë. Ne si ndërtues duhet ta dimë qartësisht se sa bonuse do të kenë ata që zbatojnë praktikën bashkëkohore të ndërtimit dhe mbi bazën e kësaj do të përcaktohet edhe interesi për të ndjekur këto nisma që synohen nga ligji.”

Znj. Mirela Kamberi, programi i
PNUD për ndryshimet klimatike

“Ne kemi përballë njëri-tjetrit, por duhet të kemi përballë përfaqësuesit e institucioneve të interesuar për rekomandimet tona. METE do të duhet të rakordojë se çfarë duhet të bëjnë donatorët dhe jemi gati të ndihmojnë edhe për ligjin edhe për suportet e tjera.

Së dyti, ky ligj nuk mund të zbatohet nëse nuk rakordohet me ministrinë e Financave dhe ministrinë e Punëve Publike. Nëse ky ligj nuk bëhet pjesë e kodit të banesave, e kodit të ndërtimit, ai nuk ka për t’u zbatuar. Duhet që këto ministri të rakordohen dhe të bashkëpunojnë për të përcaktuar masat e duhura për


zbatimin. Do të ishte mirë që vetë përfaqësuesit e institucioneve të vendosin se çfarë strategjie do të ndjekin në këtë sektor dhe më pas ne donatorët dhe ekspertët të japin mendimet apo ndihmën tonë.”

Z. Dritan Qendro, zyra e OSBE

“Këto tavolina do të sugjeroja se duhet të shkojnë edhe në nivel lokal për arsye se kanë një impakt të madh. Përsa i përket projektligjit, komentet do t’i dërgojmë më shkrim, por në një vështrim të përgjithshëm, mund të ndalemi në dy pika. Së pari, duke qënë se Shqipëria në aspektin strategjik ka deklaruar gazifikimin e vendit me projektet e mëdha që kalojnë në rajon, mendojmë se duhet të përcaktohet më mirë në projektligj në pjesën e ndërtesave të reja ky qëllim për rrjetin e gazit. Sot e dimë mjaft mirë se sa kosto ka transporti i një bombule gazi në apartamentet tona.

Një tjetër aspekt, duke patur parasysh që OSBE mbështet konventën e Aarhus-it, mendoj se ky projekt dhe diskutimet e sotme që vijnë nga të gjitha grupet e interesit dhe shoqëria civile, të diskutohen edhe me qendrën e informacionit të Aarhus-it dhe të shpërndahet tek palët e interesuara.”

Tiranë, 16 mars 2012



Public Dialogue
on the Sustainable Use of
Energy in South-East Europe

Për detaje të mëtejshme rreth iniciativës së dialogut publik mund të kontaktoni :

Akademia e Studimeve Politike
Qendra Kotoni, Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, Kati 4, Zyra 2, Tiranë
Tel: +355 4 2272173, E-mail:koordinator@shkollapolitike.org,
Web: www.shkollapolitike.org

Ndërsa për iniciativën rajonale “Dialogu Publik për Përdorimin e Qëndrueshëm të Energjisë në Europën Juglindore”, mund të mësoni më tepër në adresën online:
<http://www.publicdialogue-energy.com>